

VENDIM
Nr. 10, datë 21.3.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE
(ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 30.3.2018; nr. 140, datë 27.11.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjellës kanalizime Vlorë me:
Drejtues Ligjor *Shkëlqim Leskaj*
Drejtues Teknik Albina Xhyheri
2. Operatori Sh.a Ujësjellës kanalizime Vlorë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.
3. *Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Vlorë.*
Njësia administrative Vlorë, Qendër Vlorë, Shushicë
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

KRYETARI
Ndriçim Shani